



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME KORÇË

Nr 208 prot

Korçë më 6.9.2024

Lënda: Njoftim për Lëvizje Paralele

**Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun**

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhezimit të Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësimdhënës i Teorisë dhe Praktikes Profesionale me kohë të plotë, për "Lëndët Veterinari".

1.Kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë dhe Praktikës profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- i) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- j) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- k) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- l) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- ë) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteret e posaçme si vijon:

- e) Të ketë diplomë Përkatëse niveli Master profesional ose të barazvlefshëm me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- f) Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

3. Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi
- c) Kartën e identitetit,
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- f) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
- c) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës.....18.09.2024

TATIANA MERO
DREJTOR I SHKOLLËS

